



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 240 prot.

Tiranë më 10.022020

VENDIM

Nr. 01 , datë 10.02 .2020

PËR KONTROLLUESIN “PARR SH.P.K.”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “PARR” sh.p.k.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 362, datë 23.12.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “PARR sh.p.k.”, me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale për qëllime të video survejimit dhe zbatimi i ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit u fokusua në trajtimin e ankesës lidhur me përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të kamerave CCTV si dhe verifikimin e zbatimit të rregullave dhe detyrimeve ligjore specifike gjatë këtij procesi përpunues.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit “PARR sh.p.k.”, konstaton se:

1. Kontrolluesi “PARR sh.p.k.” e ushtron veprimtarinë në fushën e call center. Në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë ka instaluar një sistem kamerash CCTV. Kameran janë pozicionuar në ambientet e brendshme të zyrave dhe ambientet e jashtme. Aksesit në këtë sistem është i kufizuar nëpërmjet “emrit të përdoruesit” dhe “fjalëkalimit”. Afati i mbajtjes dhe ruajtjes së regjistrimeve

është në përputhje me afatet e parashikuara në Udhëzimin nr.3/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi me iniciale J.K., lidhur me mungesën e tabelave informuese për sistemin e video survejimit (CCTV) dhe mungesën e informimit mbi mënyrën dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave nëpërmjet këtij sistemi, u konstatua se në ambientet e brendshme të kontrolluesit janë vendosur tabelat informuese por nuk janë sipas standardit të miratuar nga Udhëzimi nr.3/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se tabelat informuese të vendosura, nuk reflektojnë elementet e domosdoshme që garantojnë informimin e plotë të subjekteve të të dhënave në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr.9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë mungesën e informimit mbi të drejtat ligjore që gëzojnë subjektet e të dhënave në kuadër të përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV).

Kontrolluesi, nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), përpunon të dhëna “*imazhe-video*” të subjekteve të të dhënave “*punëmarrës*” dhe “*vizitorë*”. Si rregull, sistemi i video survejimit vendoset për qëllime sigurie dhe nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve. Të dhënat e ruajtura në sistemin e video survejimit si “*imazhe*” apo “*video*”, janë të dhëna personale për arsye se një individ mund të identifikohet drejtpërdrejtë apo tërthorazi në bazë të këtyre regjistrimeve. Mungesa e informimit të subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video survejimit (CCTV), përbën shkelje administrative të nenit 18, pika 1 të ligjit: “*Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale*” dhe Udhëzimit nr.3/2010 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*” i ndryshuar.

3. Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla të brendshme specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, ku të parashikohen procedurat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë fizike, teknike dhe organizative të të dhënave, përcaktimin e të drejtave të aksesit, afatet e mbajtjes së të dhënave personale, mënyrat dhe procedurat e shkatërrimit të sigurtë dhe konfidencial të tyre pas përfundimit të afatit dhe qëllimit të përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave personale dhe mënyrat e ushtrimit të tyre, etj, në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.3/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

Në kuadër të garantimit të sigurisë së të dhënave personale që përpunohen në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Zyra e Komisionerit vlerëson si mjaft të rëndësishëm hartimin e rregullores për

mbrojtjen e të dhënave personale lidhur me këtë lloj përpunimi, pasi përbën bazën e referimit për përpunimin e të dhënave nga çdo punonjës përgjegjës, përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale dhe respektimin e plotë të të drejtave të subjekteve të të dhënave, duke shmangur pasojat e rënda që mund të vijnë ndaj tyre.

Kontrolluesi "PARR" sh.p.k bën pjesë në kategorinë e kontrolluesve të mëdhenj në kuptim të Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2018, për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha".

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron dhe masave të shtuara të sigurisë që ky i fundit kërkon në aspekt të mbrojtjes së të dhënave, kontrolluesi në fjalë, me qëllim garantimin e këtij niveli sigurie duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin 48 datë 14.09.2018 "Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre" duke vlerësuar mundësinë e certifikimit të sistemeve të sigurisë së menaxhimit të të dhënave në përputhje me kërkesat e këtij të fundit.

4. Nga analizimi i pozicionit të kamerave u konstatua gjithashtu se një kamer është e pozicionuar në ambientet e brendshme të përbashkëta të pallatit dhe regjistron të gjithë banorët ndërsa një kamer tjetër është e fokusuar në hyrjen e garazhit të pallatit. Në referim të Udhëzimit nr.3/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, në këtë rast nuk ishte marrë miratimi/pëlqimi në mënyrë të shkruar, i 75% të banorëve të pallatit. Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem, nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Instalimi i kamerave, nga ana e kontrolluesit, në ambientet e pallatit është në tejkalim të qëllimit të përpunimit, që në rastin konkret është siguria e biznesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të video survejimit (CCTV) në ambientet e brendshme të përbashkëta të pallatit dhe hyrjen e garazhit të pallatit, çënon privatësinë e banorëve të pallatit dhe kalimtarëve të rastit dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë (neni 5 i ligjit) pasi kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për të realizuar qëllimin (garantimin e sigurisë së biznesit). Ky konstatim, përbën shkelje të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e kontrolluesit "PARR" sh.p.k janë paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit, kanë pranuar shkeljet e konstatuara dhe kanë paraqitur prova duke pretenduar se janë rikuperuar shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Lidhur me pretendimet dhe provat e paraqitura nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se:

- Sa i përket plotësimit të detyrimit për informim, nëpërmjet tabelave informuese të vendosura në ambientet e kontrolluesit, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, Zyra e Komisionerit pasi analizoi përsëri standartin e sjellë nga kontrolluesi, vlerëson se nuk reflekton në mënyrë të plotë elementet e domosdoshme që garantojnë informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas standartit të miratuar me Udhëzimin nr.3/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise te tjera", i ndryshuar.
- Sa i përket konstatimeve lidhur me mungesën e hartimit të rregullave të brendshme specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV, Zyra e Komisionerit thekson se pavarësisht faktit që kjo e fundit nuk është paraqitur gjatë inspektimit, por në seancë, përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore, parimet dhe rregullat specifike të parashikuara në ligjin nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.3/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise te tjera", i ndryshuar, të miratuar nga Zyra e Komisionerit.

Mungesa e këtyre rregullave për një kohë të gjatë përbën një rrezik potencial për sigurinë e të dhënave personale dhe përpunim të paligjshëm të tyre, që mund të kishte sjellë pasoja të rënda në privatësi.

- Lidhur me konstatimin e pozicionit të kamerave në ambientet e brendshme të përbashkëta të pallatit dhe në hyrjen e garazhit të pallatit, Zyra e Komisionerit vlerëson se duke marrë parasysh kohën e gjatë të instalimit dhe monitorimit në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, pasojat ndaj privatësisë së banorëve dhe kalimtarëve të rastit janë të rënda dhe të shtrira në kohë.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat "a" dhe "dh" të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

1. *Kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

2. *Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.*

Në bazë të nenit 39/2 të Ligjit Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze dhe kontrolluesi nuk ka reflektuar në mënyrë të plotë lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 6, 27, 29, 30, 39 pika 1 gërmat “a” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit “PARR” sh.p.k me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit “PARR” sh.p.k me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
3. Kontrolluesi “*PARR sh.p.k*”, në zbatim të nenit 18 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, të ndryshojë standartin e tabelave informuese mbi sistemin CCTV sipas standardit të miratuar nga Udhëzimi nr.3/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.
4. Kontrolluesi “*PARR sh.p.k*”, në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, të reflektojë në mënyrë të plotë, në rregulloren e brendshme për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV, detyrimet ligjore, parimet dhe rregullat specifike të parashikuara në ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.3/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.
5. Kontrolluesi “PARR” sh.p.k , për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme duke vlerësuar mbi çertifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre.

6. Kontrolluesi "PARR" sh.p.k, ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në pikën 3 dhe 4 të këtij vendimi, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e aktit.
7. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 10.2.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

